VENDIM
Nr. 482, datë 16.7.2014

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 766, DATË 14.9.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE PËR SIGURINË KOMPJUTERIKE (ALCIRT)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas shkronjës "f", të pikës 3, të vendimit nr. 766, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja "g", me këtë përmbajtje:

"g) Ngre, administron dhe mirëmban portalin *online* që do t'u shërbejë personave juridikë, publikë dhe privatë, për të publikuar adresat e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre, si dhe ofruesve të shërbimit të aksesit në internet (ISP-ve) për marrjen e informacionit me qëllim mbylljen e aksesit në këto faqe sipas legjislacionit në fuqi. ALCIRT-i nxjerr udhëzime dhe urdhra për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë shkronjë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama